

LIGJ
Nr. 143/2020

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË HUAS NDËRMJET REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË DHE BANKËS EVROPIANE PËR RINDËRTIM DHE
ZHVILLIM PËR PROGRAMIN PËR ZHVILLIMIN E TURIZMIT DHE
INFRASTRUKTURËS NË SHQIPËRI**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, e 121, pika 1, shkronja “ç”, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja e huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për programin për zhvillimin e turizmit dhe infrastrukturës në Shqipëri, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 3.12.2020

Shpallur me dekretin nr. 11868, datë 15.12.2020 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta

VERSIONI I NËNSHKRUAR
(Numri i veprimt: 49351)

MARRËVESHJE HUAJE
(PROGRAMI PËR ZHVILLIMIN E TURIZMIT DHE INFRASTRUKTURËS NË
SHQIPËRI) NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS
EVROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM
Datë 8 tetor 2020

TABELA E PËRMBAJTJES

NENI I - TERMAT DHE KUSHTET STANDARDË; PËRKUFIZIMET

Seksioni 1.01 Përfshirja e Termave dhe Kushteve Standarde

Seksioni 1.02 Përkufizime

Seksioni 1.03 Interpretimi

NENI II - KUSHTET E PRINCIPALIT TË HUAS

Seksioni 2.01 Shuma dhe monedha

Seksioni 2.02 Kushte të tjera financiare të huas

Seksioni 2.03 Tërheqjet dhe Llogaria e Veçantë e Përcaktuar

Seksioni 2.04 Përfaqësuesi i autorizuar për tërheqjet
 NENI III - EKZEKUTIMI I PROJEKTT
 Seksioni 3.01 Angazhime të tjera afirmuese në lidhje me Projektin
 Seksioni 3.02 Njësia e zbatimit të projektit
 Seksioni 3.03 Prokurimi
 Seksioni 3.04 Angazhimet e pajtueshmërisë mjedisore dhe sociale
 Seksioni 3.05 Konsulentët
 Seksioni 3.06 Angazhime negative
 Seksioni 3.07 Kërkesat e shpeshtësisë së raportimit dhe kërkesat e dorëzimeve
 NENI IV - ANGAZHIME FINANCIARE
 Seksioni 4.01 Regjistrat dhe raportet financiare
 NENI V - PEZULLIMI; PËRSHPEJTIMI; ANULIMI
 Seksioni 5.01 Pezullimi
 Seksioni 5.02 Anulimi
 NENI VI – EFEKTIVITETI
 Seksioni 6.01 Kushtet paraprake të efektivitetit
 Seksioni 6.02 Kushtet paraprake të tërheqjes së parë
 Seksioni 6.03 Opinioni ligjor
 Seksioni 6.04 Kushtet paraprake të angazhimit të Transhit B
 Seksioni 6.05 Kushtet paraprake për të gjitha tërheqjet
 Seksioni 6.06 Zgjidhja për shkak të moshyrjes në fuqi
 NENI VII - TË NDRYSHME
 Seksioni 7.01 Njoftimet
 Skeduli 1 – Përshkrimi i Projektit S1-1
 Skeduli 2 – Kriteret e pranimit për Nënprojektet S2-1
 Skeduli 3 – Kategoritë dhe tërheqjet S3-1
 Skeduli 4 – Llogaria e Veçantë e Përcaktuar S4-1
 ANEKSI 1 – Plani i Veprimit Mjedisor dhe Social A1-1
 ANEKSI 2 – Raportimi tremujor A2-1

MARRËVESHJE E HUAS

Marrëveshje e datës 8 tetor 2020 ndërmjet Republikës së Shqipërisë (Huamarrësi) dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (Banka).

PREAMBULË

Duke pasur parasysh se Banka është themeluar për të mundësuar financim për projekte specifike, me qëllim lehtësimin e kalimit drejt ekonomive të hapura të orientuara nga tregu dhe promovimin e nismave private dhe sipërmarrëse në vende të caktuara të angazhuara për dhe që zbatojnë parimet e demokracisë shumëpartiake, pluralizmit dhe ekonomive të tregut;

duke pasur parasysh se Huamarrësi, nëpërmjet Fondit Shqiptar të Zhvillimit (Agjencia e Zbatimit të Programit), synon të zbatojë Projektin, siç përshkruhet në skedulin 1, që është projektuar për të ndihmuar Huamarrësin të përmirësojë konkurrueshmërinë nëpërmjet financimit të Nënprojekteve që përmbushin Kriteret e Pranimit të përcaktuara në skedulin 2, lidhur me: A. Investimet në Infrastrukturë për zhvillimin e turizmit në Rajonet e Përcaktuara (Komponenti A); dhe B. Investime të përgjithshme në Infrastrukturën e bashkisë dhe të transportit për përmirësimin e turizmit në mbarë territorin e Huamarrësit (Komponenti B);

duke pasur parasysh se Projekti do të zhvillohet nga Agjencia e Zbatimit të Programit me anë të ndihmës financiare të Huamarrësit;

duke pasur parasysh se Huamarrësi ka kërkuar ndihmën e Bankës për financimin e pjesshëm të Projektit;

duke pasur parasysh se Banka ka rënë dakord të planifikojë bashkëpunim teknik dhe investim nëpërmjet fondeve në formën e granteve, për t'u mundësuar nga Bashkimi Evropian, me qëllim asistimin e Huamarrësit për të zbatuar Projektin (Financimi nga Granti), që u nënshtrohet termave dhe kushteve të përcaktuar në një marrëveshje (Marrëveshja e Granti) ndërmjet Bankës dhe Huamarrësit; dhe

duke pasur parasysh se Banka ka rënë dakord që për sa më sipër, ndër të tjera, t'i japë Huamarrësit një hua në shumën deri në 60,000,000 euro, që u nënshtrohet termave dhe kushteve të përcaktuar ose të referuara në këtë Marrëveshje,

për rrjedhojë, Palët bien dakord si më poshtë:

Neni I

Termat dhe kushtet standardë; përkufizimet

Seksioni 1.01 Përfshirja e Termave dhe Kushteve Standarde

Të gjitha dispozitat e Termave dhe Kushteve Standardë të Bankës të datës 1 tetor 2018 përfshihen dhe janë të zbatueshme në këtë Marrëveshje me të njëjtin efekt dhe fuqi, sikur të ishin të përcaktuara plotësisht në të, por megjithatë, u nënshtrohen ndryshimeve të mëposhtme (dispozitat përkatëse të ndryshuara referohen në vijim si "Termat dhe Kushtet Standardë"):

a) Përkufizimi i "Shumës së Disponueshme" në seksionin 2.02 të Termave dhe Kushteve Standardë, për qëllime të kësaj Marrëveshjeje, ndryshohet me tekstin e mëposhtëm:

"Shumë e Disponueshme" nënkupton: i. deri në, por pa përfshirë Datën e Disponueshmërisë së Transhit B dhe atë pjesë të Transhit A të Huas, që, sipas rastit, nuk është anuluar ose tërhequr apo i është nënshtrohet një Angazhimi të kushtëzuar ose të pakushtëzuar për Rimbursim; dhe ii. nga dhe duke përfshirë Datën e Disponueshmërisë së Transhit B dhe atë pjesë të Huas, që, sipas rastit, nuk është anuluar ose tërhequr apo i është nënshtrohet një Angazhimi të kushtëzuar ose të pakushtëzuar për Rimbursim (dhe të gjithë termat me shkronjë kapitale në këtë përkufizim dhe që nuk përcaktohen ndryshe në këtë Marrëveshje, kanë kuptimet e përcaktuara në Marrëveshjen e Huas).".

b) Seksioni 3.05 (Tarifa e Angazhimit dhe Komisioni Paraprak) e Termave dhe Kushteve Standardë, për qëllime të kësaj Marrëveshjeje, ndryshohet me tekstin e mëposhtëm:

"a) Huamarrësi i paguan Bankës një tarifë angazhimi në normën e pagueshme të përcaktuar në Marrëveshjen e Huas ndaj vlerës totale të Shumës së Disponueshme plus çdo shumë të Huas që i nënshtrohet Angazhimit për Rimbursim dhe që nuk është tërhequr ende, me kusht që Tarifa e Angazhimit e pagueshme ndaj shumës së Huas që i nënshtrohet një Angazhimi të pakushtëzuar për Rimbursim të jetë 0.5% në vit më e lartë se sa norma e Tarifës së Angazhimit të përcaktuar në Marrëveshjen e Huas. Tarifa e Angazhimit ngarkohet:

1. Për Transhin A, nga data 60 (gjashtëdhjetë) ditë pas datës së Marrëveshjes së Huas; dhe

2. Për Transhin B, nga data 7 (shtatë) ditë pas Datës së Disponueshmërisë së Transhit B; ose

3. Në rast të Tarifës së Angazhimit të pagueshme ndaj shumës së Huas që i nënshtrohet një Angazhimi të pakushtëzuar për Rimbursim, nga data e lëshimit të Angazhimit të pakushtëzuar për Rimbursim në fjalë;

4. Dhe në secilin nga rastet, Tarifa e Angazhimit ngarkohet dhe llogaritet mbi të njëjtën bazë si interesi i përcaktuar në seksionin 3.04(b)(ii). Tarifa e Angazhimit bëhet e pagueshme

në çdo Datë të Pagesës së Interesit (pavarësisht nëse ka interes të pagueshëm në atë datë), duke filluar që nga Data e parë e Pagesës së Interesit pas Datës së Hyrjes në Fuqi.

b) Huamarrësi i paguan Bankës komision paraprak në vlerën një për qind (1%) të shumës së principalit të huas, si më poshtë:

i. për Transhin A, 300,000] (tre mijë euro); dhe

ii. për Transhin B, 300,000] (tre mijë euro).

c) Banka, në emër të Huamarrësit, tërheq nga shuma e disponueshme dhe i paguan vetes shumën e Komisionit Paraprak të pagueshëm në përputhje me seksionin 3.05(b):

i. për Transhin A, në Datën e Hyrjes në Fuqi ose brenda 7 (shtatë) ditëve nga ajo datë; dhe

ii. për Transhin B, në Datën e Disponueshmërisë së Transhit B ose brenda 7 (shtatë) ditëve nga ajo datë.

d) Të gjithë termat me shkronjë kapitale në këtë seksion 3.05 dhe që nuk përkufizohen ndryshe në këta Terma dhe Kushte Standardë, kanë kuptimin e përcaktuar në Marrëveshjen e Huas.

Seksioni 1.02 Përkufizime

Kurdo që përmenden në këtë Marrëveshje (duke përfshirë preambulën dhe shtojcat) dhe për sa kohë që nuk përcaktohet apo nuk kërkohet ndryshe nga konteksti, termat e përkufizuar në preambulë kanë kuptimet përkatëse të përcaktuara në të, termat e përkufizuar në Termat dhe Kushtet Standardë kanë kuptimet përkatëse të përcaktuar në to dhe termat e mëposhtëm kanë kuptimet si vijon:

“Autorizim” nënkupton çdo pëlqim, regjistrim, depozitim, marrëveshje, noterizim, certifikatë, licencë, miratim, leje, autoritet apo përjashtim nga ose me anë të Autoritetit Qeveritar, qoftë ky i dhënë apo i mohuar nëpërmjet veprimit të shprehur ose të konsideruar si të dhënë apo të mohuar, për shkak të mosveprimit brenda një periudhe të caktuar kohe dhe të gjitha miratimet ose pëlqimet e korporatës, kreditorëve dhe aksionarëve.

“Përfaqësues i Autorizuar i Huamarrësit” nënkupton ministrin e Financave dhe Ekonomisë të Huamarrësit.

“Komponenti A” nënkupton investimet në Infrastrukturë për zhvillimin e turizmit në Rajonet e Përcaktuara

“Komponenti B” nënkupton investimet e përgjithshme në Infrastrukturën e bashkisë dhe ransportit për zhvillimin e turizmit në mbarë territorin e Huamarrësit.

“Kërkesat e Performancës së Përcaktuar” nënkupton Kërkesat e Performancës nga 1 në 8 ose 10 (ose, sipas kontekstit, cilëndo nga Kërkesat e Performancës) të Kërkesave të Performancës së muajit maj 2014 dhe që lidhen me Politikën Mjedisore dhe Sociale.

“Rajonet e Përcaktuara” nënkupton bashkitë e Beratit, Korçës, Fierit dhe Shkodrës për t’u financuar sipas Komponentit A.

“Rregullat e Prokurimit të BERZH-it” nënkupton Politikën dhe Rregullat e Prokurimit të datës 1 nëntor 2017 për projektet e financuara nga Banka.

“Kriteret e Pranimit” nënkupton kriteret e pranimit për vlerësimin e Nënprojekteve, siç përcaktohet në shtojcën 2 bashkëlidhur.

“Politika dhe Procedurat e Zbatimit të Detyruar” nënkupton Politikën dhe Procedurat e Zbatimit të Detyruar të Bankës të datës 4 tetor 2017.

“Plani i Veprimit Mjedisor dhe Social” nënkupton planin e masave mjedisore dhe sociale lehtësuese dhe përmirësuese të datës 12 shkurt 2020 të përgatitur nga Banka, një kopje e të cilit është bashkëlidhur si aneksi 1 dhe që mund të ndryshohet sipas rastit, me pëlqimin paraprak me shkrim të Bankës në përputhje me seksionin 3.04(d).

“Ligji Mjedisor dhe Social” nënkupton çdo ligj ose rregullore në fuqi që lidhet me:

a) ndotjen ose mbrojtjen e mjedisit, duke përfshirë ligjet ose rregulloret shoqëruese që lidhen me pjesëmarrjen në vendimmarrje;

- b) kushtet e punës dhe punësimit;
- c) shëndetin dhe sigurinë në punë;
- d) shëndetin dhe sigurinë publike;
- e) personat indigjenë;
- f) trashëgiminë kulturore; ose
- g) rivendosjen ose shpërnguljen ekonomike të personave.

“Çështje Mjedisore dhe Sociale” nënkupton çdo çështje që i nënshtrohet Ligjit Mjedisor dhe Social, ndonjë Kërkese të Performancës së Përcaktuar ose Planit të Veprimit Mjedisor dhe Social.

“Politikat Mjedisore dhe Sociale” nënkupton Politikat Mjedisore dhe Sociale të Bankës të muajit maj 2014.

“Vit Fiskal” nënkupton vitin fiskal të Huamarrësit, duke filluar nga data 1 janar e çdo viti.

“Autoritet Qeveritar” nënkupton qeverinë e Huamarrësit ose ndonjë nënndarje politike përkatëse, qoftë rajonale ose vendore dhe çdo agjenci, autoritet, degë, departament, organ rregullator, gjykatë, bankë qendrore apo ent tjetër që ushtron pushtet ose funksion ekzekutiv, legjislativ, gjyqësor, tatimor, rregullator apo administrativ të qeverisë ose të lidhur me të apo nënndarjet përkatëse (duke përfshirë organet mbikombëtare), dhe të gjithë zyrtarët, agjentët dhe përfaqësuesit përkatës.

“SNRF” nënkupton Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar të nxjerra ose të miratuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe që zbatohen rregullisht.

“Infrastrukturë” nënkupton objektet fizike që mundësojnë shërbime me rëndësi për publikun e përgjithshëm dhe që janë të nevojshme për zhvillimin e sektorit privat, duke përfshirë, por pa u kufizuar, në:

- a) sektorin e energjisë elektrike: impiantet e prodhimit të energjisë dhe rrjetet e shpërndarjes së energjisë;
- b) sektorin e telekomunikacionit: sistemet për komunikimet telefonike vendëse dhe në distancë dhe rrjetet e transmetimit të të dhënave;
- c) sektorin e ujit: impiantet e desalinimit, impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura, strukturat e shpërndarjes së ujit;
- d) sektorin e pastrimit: strukturat dhe pajisjet për grumbullimin dhe asgjësimin e mbetjeve;
- e) sektorin e transportit: instalimet fizike dhe sistemet e përdorura për transportin publik, të tilla si: hekurudhat urbane dhe ndërrbane, trenat nëntokësorë, linjat e autobusëve, rrugët, urat, tunelet, portet, linjat ajrore dhe aeroportet; dhe
- f) rigjenerimin e infrastrukturës urbane: instalimin e ndriçimeve të reja rrugore dhe riparimin e hapësirave për këmbësorët dhe/ose shëtitoret.

“NJZP” nënkupton njësinë e zbatimit të projektit të përmendur në seksionin 3.02.

“Plani i Prokurimit” nënkupton planin e prokurimit për Nënprojektet, siç është rënë dakord ndërmjet Huamarrësit nëpërmjet Agjencisë së Zbatimit të Programit dhe Bankës, plan që mund të ndryshohet, sipas rastit, me pëlqimin paraprak me shkrim të Bankës.

“Agjencia e Zbatimit të Programit” është Fondi Shqiptar i Zhvillimit (FSHZH).

“Llogaria e Veçantë e Përcaktuar” nënkupton llogarinë e veçantë të përcaktuar të depozitës së përmendur në seksionin 2.03 dhe shtojcën 4. Llogaria e Veçantë e Përcaktuar përbën “Llogarinë e Veçantë”, pasi ky term përdoret në Udhëzuesin e Disbursimit të BERZH-it.

“Nënprojekt” nënkupton secilin nga projektet e investimit që do të financohen nga Huaja lidhur me Projektin dhe që përmbushin Kriteret e Pranimit.

“Transhi A” ka kuptimin e përcaktuar në seksionin 2.01(b)(1).

“Transhi B” ka kuptimin e përcaktuar në seksionin 2.01(b)(2).

“Data e Disponueshmërisë së Transhit B” nënkupton datën në të cilën Transhi B është angazhuar dhe bëhet i disponueshëm dhe mund të Tërhiqet me njoftimin e Bankës drejtuar Huamarrësit, që i nënshtrohet, ndër të tjera, përmbushjes së kushteve paraprake të përcaktuara në seksionin 6.04 (Kushtet Paraprake të Angazhimit të Transhit B) në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Bankën. Vendimi për ta bërë Transhin B të disponueshëm për Huamarrësin merret nga Banka, e cila vepron në diskrecionin e saj të vetëm dhe absolut.

Seksioni 1.03 Interpretimi

Në këtë Marrëveshje, referenca ndaj një neni, seksioni ose shtojce të caktuar, përveçse kur përcaktohet ndryshe në këtë Marrëveshje, interpretohet si referencë ndaj nenit, seksionit ose shtojcës së caktuar të kësaj Marrëveshjeje.

Neni II

Kushtet e principalit të Huas

Seksioni 2.01 Shuma dhe Monedha

a) Banka bie dakord t’i japë Huamarrësit, bazuar në termat dhe kushtet e përcaktuar apo të referuara në këtë Marrëveshje, shumën prej 60,000,000 (gjashtëdhjetë milionë) eurosh.

b) Huaja përbëhet nga dy transhe, si vijon:

1. Transhi A në shumën 30,000,000 (tridhjetë milionë) euro; dhe

2. Transhi B në shumën 30,000,000 (tridhjetë milionë) euro.

Pavarësisht kundërshtimeve, të shprehura ose të nënkuptuara, në këtë Marrëveshje, Transhi B është i paangazhuar dhe, si rrjedhojë, Banka nuk ka asnjë detyrim për të mundësuar shumën për Tërheqje nga Transhi B, përveç kur ka vendosur, në diskrecionin e saj absolut, se është e gatshme ta bëjë Transhin B të disponueshëm për disbursim dhe të ketë njoftuar Huamarrësin lidhur me këtë vendim, nëse ndodh.

Seksioni 2.02 Kushte të Tjera Financiare të Huas

a) Shuma Minimale për Tërheqje do të jetë 500,000 euro, me kusht që asnjë tërheqje të mos bëhet më shumë se një herë në (45) dyzet e pesë ditë kalendarike.

b) Shuma Minimale e Parapagimit është 1,000,000.] euro.

c) Shuma Minimale e Anulimit është 1,000,000. euro.

d) Datat e Pagesës së Interesit janë 10 maj dhe 10 nëntor të çdo viti.

e) 1. Huamarrësi shlyen Transhin A në njëzet e dy këste 6-mujore të barabarta (ose aq të barabarta sa të jetë e mundur) më 10 maj dhe 10 nëntor të secilit vit, duke filluar nga Data e parë e Shlyerjes së Huas, duke filluar në ose pas datës së përvjetorit të katërt të nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje.

2. Huamarrësi shlyen Transhin B në njëzet e dy këste 6-mujore të barabarta (ose aq të barabarta sa të jetë e mundur) më [15 maj] dhe [15 nëntor] të secilit vit, duke filluar nga Data e parë e Shlyerjes së Huas për Transhin B, që është Data e parë e Pagesës së Interesit, që përkon në ose menjëherë pas përvjetorit të katërt të datës së njoftimit të kryer nga Banka për Datën e Disponueshmërisë së Transhit B dhe Data e fundit e Shlyerjes së Huas për Transhin B që është Data e Pagesës së Interesit që përkon në ose menjëherë para përvjetorit të 15-të të datës së njoftimit të kryer nga Banka për Datën e Disponueshmërisë së Transhit B.

3. Pavarësisht sa më sipër, në rastin kur: i. Huamarrësi nuk tërheq plotësisht shumën e Huas ose të gjithë shumën e Transhit A apo të Transhit B, sipas rastit, para Datës së parë së Shlyerjes së Huas së përcaktuar në këtë seksion 2.02(e); dhe ii. Banka shtyn Datën e Fundit të Disponueshmërisë së përcaktuar në seksionin 2.02(f) më poshtë deri në një datë që është më e vonshme se Data e parë e Shlyerjes së Huas, atëherë shumën për secilën tërheqje të kryer në ose pas Datës së parë të Shlyerjes së Huas ndahet në vlera të barabarta për t’u shlyer në disa prej Datave të Shlyerjes së Huas që përkojnë pas datës së tërheqjeve

përkatëse (Banka përshtat shumat e ndara, në mënyrë që shifrat të jenë numra të plotë në secilin rast). Banka, sipas rastit, njofton Huamarrësin lidhur me këto ndarje të shumave.

f) 1. Data e Fundit e Disponueshmërisë për Transhin A është 31 dhjetor 2025 ose një datë e mëvonshme që mund të caktohet nga Banka pas marrjes së një kërkesë paraprake me shkrim nga Huamarrësi dhe që ia njofton këtij të fundit.

2. Data e Fundit e Disponueshmërisë për Transhin B është si më poshtë, cila prej tyre të ndodhë më herët: i. përvjetori i 4-të i datës së marrjes së njoftimit nga Banka, lidhur me Datën e Disponueshmërisë së Transhit B; ose iii. 31 dhjetor 2025 ose një datë e mëvonshme, që mund të përcaktohet nga Banka pas marrjes së një kërkesë paraprake me shkrim nga Huamarrësi dhe që ia njofton këtij të fundit.

g) Norma e Tarifës së Angazhimit është 0.5% në vit.

h) Huaja i nënshtrohet një Norme të Ndryshueshme Interesi.

Seksioni 2.03. Tërheqjet dhe Llogaria e Veçantë e Përcaktuar

a) Shuma e Disponueshme mund të tërhiqet sipas rastit, në përputhje me dispozitat e skedulit 2 (Kriteret e Pranimit për Nënprojektet) dhe skedulit 3 (Kategoritë dhe Tërheqjet) për të financuar: 1. shpenzimet e kryera (ose, nëse Banka bie dakord, që do të kryhen) lidhur me koston e mallrave, punimeve dhe shërbimeve të nevojshme për Projektin; dhe 2. Komisionin Paraprak.

b) Huamarrësi, për qëllime të Projektit, krijon dhe mban një llogari të veçantë të përcaktuar depozite në monedhën euro, në një bankë tregtare të pranueshme për Bankën, bazuar në termat dhe kushtet që janë të pranueshëm për Bankën. Nëse Huamarrësi dëshiron të kryejë Tërheqje për depozitim në, dhe pagesa të drejtpërdrejta nga Llogaria e Veçantë e Përcaktuar (në vend të Tërheqjeve që kryhen, sipas seksionit 2.03(a)), këto Tërheqje kryhen në përputhje me dispozitat e shtojcës 4.

Seksioni 2.04 Përfaqësuesi i Autorizuar për Tërheqjet

Ministri i Financave dhe Ekonomisë i Huamarrësit është caktuar si Përfaqësuesi i Autorizuar i Huamarrësit për kryerjen e veprimeve të nevojshme apo të lejuara për t'u kryer, sipas dispozitave të seksionit 2.03(a) dhe sipas dispozitave të seksioneve 3.01 dhe 3.02 të Termave dhe Kushteve Standardë.

Neni III

Ekzekutimi i projektit

Seksioni 3.01 Angazhime të tjera Afirmuese në lidhje me Projektin

Krahas angazhimeve të përgjithshme të përcaktuara në nenin IV të Termave dhe Kushteve Standardë, Huamarrësi (dhe, sipas rastit, siguron që Agjencia e Zbatimit të Programit), nëse Banka nuk bie dakord ndryshe:

a) ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme për të siguruar fonde të mjaftueshme për realizimin e Projektit;

b) siguron menaxhimin e përditshëm të Projektit, nga Agjencia e Zbatimit të Programit, duke përfshirë, por pa u kufizuar në menaxhimin e konsoliduar financiar dhe të prokurimit;

c) siguron që Agjencia e Zbatimit të Programit përmbush të gjitha detyrimet e veta, sipas kësaj Marrëveshjeje;

d) mundëson ose siguron mundësimin, nëse kërkohet, të të gjitha licencave, miratimeve ose pëlqimeve qeveritare të kërkuara nga Agjencia e Zbatimit të Programit për financimin dhe realizimin e Projektit, dhe kryerjen e të gjitha punëve, duke përfshirë të gjitha miratimet dhe licencat e nevojshme për të siguruar që Agjencisë së Zbatimit të Programit t'i jepet e drejta e kalimit dhe të drejta të tjera të përdorimit të tokës që nevojiten për realizimin e Projektit;

e) siguron se Agjencia e Zbatimit të Programit vlerëson dhe përzgjedh Nënprojekte të përshatshme, sipas Komponentit A dhe Komponentit B që përmbushin Kriteret përkatëse të Pranimit;

f) jo më vonë se data 31 dhjetor 2020, siguron që Agjencia e Zbatimit të Programit i paraqet Bankës një plan 6-mujor biznesi të pranueshëm, i cili përditësohet deri më 31 dhjetor të secilit vit;

g) jo më vonë se data 31 dhjetor 2020, siguron që Agjencia e Zbatimit të Programit i paraqet Bankës një listë të Nënprojekteve që do të financohen vitin pasardhës, listë e cila përditësohet deri më 31 dhjetor të secilit vit deri më 31 dhjetor 2025;

h) mbulon të gjitha rritjet e kostove që lidhen me Projektin;

i) jo më vonë se data 31 dhjetor 2025, siguron se Agjencia e Zbatimit të Programit:

1. Financon të paktën dhjetë Nënprojekte që lidhen me Infrastrukturën në territorin e Huamarrësit, duke përfshirë Rajonet e Përcaktuara;

2. Bën përpjekjet e saj më të mira për të siguruar që një shumë prej 8.5 milionë eurosh nga të ardhurat nga Financimi nga Granti të përdoret për restaurimin, përmirësimin dhe/ose zhvillimin e *site*-ve kulturore dhe natyrore, sipas Komponentit A; dhe

3. Bën përpjekjet e saj më të mira për të siguruar që të paktën dy prej Nënprojekteve të jenë shqyrtuar në lidhje me kujdesin teknik dhe që të paktën njëri prej Nënprojekteve të jetë financuar;

j) jo më vonë se data 31 dhjetor 2025, Huamarrësi nëpërmjet Agjencisë së Zbatimit të Programit përmbush kriteret e mëposhtme:

1. Të trajnojë të paktën 2,000 ofrues vendës të shërbimeve dhe produkteve turistike, me qëllim përmirësimin e kapacitetit vendës për ngritjen e objekteve të turizmit kulturor dhe kombëtar, duke përfshirë studimin e tregut dhe anketimin, instrumentet promocionale, dhe sigurimin e pjesëmarrjes së grave;

2. Të zhvillojë të paktën dymbëdhjetë paketa të reja turistike në Rajonet e Përcaktuara;

3. Të zbatojë të paktën tetë nisma të reja bashkëpunimi vendor në Rajonet e Përcaktuara;

4. Të trajnojë të paktën 200 ekspertë të institucioneve publike përkatëse dhe ekspertë të trajnuar mbi restaurimin, përmirësimin dhe/ose zhvillimin e *site*-ve të trashëgimisë kulturore dhe natyrore;

5. Të zbatojë të paktën dhjetë programe trajnimi me fokus në prioritizimin e aftësive sektoriale lidhur me nënprojektet; dhe

k) të përjashtojë nga taksat (duke përfshirë, por pa u kufizuar, TVSH-në) dhe detyrimet (duke përfshirë, por pa u kufizuar, taksat doganore) të gjitha mallrat, punimet dhe shërbimet (duke përfshirë shërbimet e konsulencës) që janë marrë për Projektin dhe që janë financuar nga të ardhurat nga Huaja ose të sigurojë rimbursimin e tyre.

Seksioni 3.02 Njësia e Zbatimit të Projektit

Me qëllim koordinimin, menaxhimin, monitorimin dhe vlerësimin e të gjitha aspekteve të zbatimit të Projektit, duke përfshirë sigurimin e mallrave, punimeve dhe shërbimeve për Projektin, Huamarrësi siguron se Agjencia e Zbatimit të Programit, nëse nuk është rënë dakord ndryshe me Bankën, krijon dhe, gjatë gjithë periudhës së zbatimit të Projektit, mban funksional njësinë e zbatimit të projektit (NJZP) me burimet e nevojshme dhe personel të kualifikuar, sipas termave të referencës të pranueshëm nga Banka.

Seksioni 3.03 Prokurimi

Për qëllime të seksionit 4.03 të Termave dhe Kushteve Standardë, dispozitat e mëposhtme, nëse Banka nuk bie dakord ndryshe, rregullojnë prokurimin e mallrave, punimeve dhe shërbimeve të nevojshme për Projektin dhe që do të financohen nga të ardhurat e Huas:

a) Mallrat, punimet dhe shërbimet (përveç shërbimeve të konsulentëve që janë të përfshira në seksionin 3.03(c)) prokurohen nëpërmjet tenderimit të hapur.

b) Për qëllimet të seksionit 3.03(a), procedurat për tenderimin e hapur, tenderimin e hapur të thjeshtuar, kontraktimin e drejtpërdrejtë dhe standardet për procedura alternative të prokurimit, në përputhje me legjislacionin kombëtar, janë përcaktuar në seksionin III, neni 3 i Rregullave të Prokurimit të BERZH-it.

c) Konsulentët që do të punësohen nga Agjencia e Zbatimit të Programit për të asistuar në realizimin e Projektit, në përputhje me seksionet 3.05(a)(1), 3.05(a)(2) dhe 3.05(a)(3), përzgjidhen në pajtim me procedurat e përcaktuara në seksionin III, neni 5 të Rregullave të Prokurimit të BERZH-it.

d) Të gjitha kontratat u nënshtrohen procedurave të shqyrtimit të përcaktuara në Rregullat e Prokurimit të BERZH-it dhe i nënshtrohen shqyrtimit paraprak nga ana e Bankës.

e) Për sa u përket kontratave, pagesa e të cilave do të sigurohet nga Llogaria e Veçantë e Përcaktuar, ndiqen procedurat e prokurimit që garantojnë përmbushjen e kërkesave të shqyrtimit në seksionin 3.03(d), para kryerjes së pagesës së parë nga Llogaria e Veçantë për kontratën në fjalë.

Seksioni 3.04 Angazhimet e Pajtuëshmërisë Mjedisore dhe Sociale

Pa cenuar tërësinë e seksioneve 4.02(a), 4.04(a)(iii), dhe 5.02(c)(iii) të Termave dhe Kushteve Standardë dhe, nëse Banka nuk bie dakord ndryshe:

a) Huamarrësi zbaton drejtpërdrejt, nëpërmjet Agjencisë së Zbatimit të Programit ose në të kundërt (kur është e përshtatshme), bën që të gjithë kontraktuesit të zbatojnë Projektin në përputhje me Kërkesat e Performancës së Përcaktuar, Ligjet Mjedisore dhe Sociale dhe të gjitha lejet, licencat, certifikatat dhe miratimet mjedisore.

b) Pa cenuar sa më sipër, Huamarrësi, drejtpërdrejt, nëpërmjet Agjencisë së Zbatimit të Programit ose në të kundërt (kur është e përshtatshme), zbaton dhe respekton me përpikëri Planin e Veprimit Mjedisor dhe Social (duke përfshirë dispozitat që përcaktojnë se Projekti nuk përfshin asnjë veprimtari të Kategorisë A në përputhje me Kërkesat e Performancës) dhe monitoron zbatimin e planit, në përputhje me dispozitat e monitorimit të përfshira në të.

c) Huamarrësi, nëpërmjet Agjencisë së Zbatimit të Programit, dhe Banka, sipas rastit, mund të bien dakord që të ndryshojnë Planin e Veprimit Mjedisor dhe Social, në mënyrë që t'u përshtaten ndryshimeve të rrethanave të Projektit apo të Huamarrësit, rasteve të paparashikuara dhe rezultateve të monitorimit. Pa cenuar tërësinë e sa më sipër:

1. Nëse ekziston ndonjë ndikim i padëshirueshëm ose problematikë mjedisore apo sociale, që nuk është parashikuar apo shqyrtuar në Planin e Veprimit Mjedisor dhe Social, qoftë plotësisht apo lidhur me shkallën e ndikimit apo rastit;

2. Nëse ndonjë nga masat zbutëse të ndikimit, që është përcaktuar në Planin e Veprimit Mjedisor dhe Social, nuk është e mjaftueshme për të eliminuar apo për të zvogëluar ndikimin mjedisor ose social në nivelin e konsideruar nga Kërkesat përkatëse të Performancës së Përcaktuar brenda afatit të parashikuar në Planin e Veprimit Mjedisor dhe Social; ose

3. Nëse vihet re ndonjë papajtuëshmëri materiale me Planin e Veprimit Mjedisor dhe Social ose me ndonjë prej Ligjeve Mjedisore dhe Sociale gjatë një inspektimi të kryer nga autoritete rregullatore ose të zbatimit të ligjit,

Huamarrësi, siguron se Agjencia e Zbatimit të Programit, sa më parë të jetë e mundur dhe me pëlqimin e Bankës, harton ose rishikon dhe përfshin në Planin e Veprimit Mjedisor dhe Social masa zbutëse shtesë, që mund të nevojiten për të qenë në përputhje me Kërkesat e Performancës së Përcaktuar, në çdo rast në një mënyrë që përmbush kërkesat e Bankës.

Seksioni 3.05 Konsulentët

a) Në mënyrë që të ndihmojë në zbatimin e Projektit, Huamarrësi, siguron se Agjencia e Zbatimit të Programit, nëse Banka nuk bie dakord ndryshe, punëson ose kërkon që të

punësohen, sipas nevojës, dhe përdor shërbimin e konsulentëve, kualifikimet, përvojën dhe termat e referencës së të cilëve janë të pranueshme për Bankën, duke përfshirë:

1. Konsulentët për të ndihmuar NJZP-në në projektim dhe për të ofruar shërbime të mbikëqyrjes (do të kontraktohen nga Agjencia e Zbatimit të Programit);

2. Konsulentët për të ndihmuar NJZP-në në kujdesin e duhur teknik dhe për të mbështetur zbatimin e Projektit (për t'u kontraktuar nga Agjencia e Zbatimit të Programit);

3. Konsulentët për të ndihmuar në zhvillimin e një modeli të bazuar në turizëm për zhvillimin ekonomik vendës (do të kontraktohen nga Agjencia e Zbatimit të Programit);

4. Konsulentët për të ndihmuar në zhvillimin e një programi të përfshirjes gjinore dhe ekonomike (do të kontraktohen nga Agjencia e Zbatimit të Programit);

5. Konsulentët për të ndihmuar në ngritjen e një këshilli sektorial të aftësive (do të kontraktohen nga Banka); dhe

6. Konsulentët për të ndihmuar në monitorimin, vlerësimin dhe verifikimin e progresit dhe të zbatimit të programit të përfshirjes gjinore dhe ekonomike dhe modelit të bazuar në turizëm për zhvillimin ekonomik vendës (do të kontraktohen nga Banka).

b) Huamarrësi siguron që Agjencia e Zbatimit të Programit u ofron, pa pagesë:

1. Konsulentëve të angazhuar për të ndihmuar me çështjet që lidhen me Projektin ose funksionet e Huamarrësit, të gjitha mbështetjen e arsyeshme dhe të nevojshme për kryerjen e funksioneve të tyre;

2. Konsulentëve të angazhuar për të ndihmuar NJZP-në, të gjitha instrumentet dhe mbështetjen e nevojshme për kryerjen e funksioneve të tyre, duke përfshirë hapësirën e zyrës.

Seksioni 3.06 Angazhime Negative

Krahas angazhimeve të përgjithshme të përcaktuara në nenin IV të Termave dhe Kushteve Standardë, Huamarrësi, siguron që Agjencia e Zbatimit të Programit, nëse Banka nuk bie dakord ndryshe:

a) përdor asnjë nga të ardhurat nga Huaja për restaurimin, përmirësimin dhe/ose zhvillimin e *site*-ve të trashëgimisë kulturore dhe natyrore, sipas Komponentit A; dhe

b) përdor asnjë nga të ardhurat nga Huaja për shpenzime që nuk lidhen me Nënprojektet që përmbushin Kriteret e Pranimit dhe që konsiderohen si Infrastrukturore në këtë Marrëveshje.

Seksioni 3.07 Kërkesat e Shpeshtësisë së Raportimit dhe Kërkesat e Dorëzimeve

a) Duke filluar nga Data e Hyrjes në Fuqi deri në momentin e shlyerjes apo të anulimit të shumës së plotë të Huas, Huamarrësi siguron që Agjencia e Zbatimit të Programit i dorëzon Bankës raporte vjetore mbi Çështjet Mjedisore dhe Sociale, që lidhen me Agjencinë e Zbatimit të Programit ose Projektin, brenda 120 ditëve nga përfundimi i vitit përkatës të raportimit. Këto raporte përfshijnë informacion mbi çështjet specifike të mëposhtme:

1. Informacion mbi pajtueshmërinë e Agjencisë së Zbatimit të Programit me Kërkesat e Performancës së Përcaktuar, siç përshkruhet në seksionin 3.04(a) dhe mbi zbatimin e Planit të Veprimit Mjedisor dhe Social;

2. Informacion mbi mënyrën se si Agjencia e Zbatimit të Programit ka monitoruar pajtueshmërinë e kontraktuesve të angazhuar në Projekt me Kërkesat e Performancës së Përcaktuar dhe një përmbledhje të ndonjë pajtueshmërie materiale të kontraktuesve në fjalë me Kërkesat e Performancës së Përcaktuar dhe Planin e Veprimit Mjedisor dhe Social, si dhe informacion mbi masat e mundshme që janë marrë për korrigjimin e pajtueshmërisë;

3. Informacion mbi zbatimin e planit të angazhimit të palëve të interesit të përcaktuar në kërkesën nr. 10 të Performancës së Përcaktuar, duke përfshirë një përmbledhje të ankesave të marra dhe mënyrën se si ato janë zgjidhur;

4. Informacion mbi pajtueshmërinë e Agjencisë së Zbatimit të Programit me Ligjet Mjedisore dhe Sociale lidhur me Projektin, duke përfshirë një përshkrim të çdo pretendimi, ndjekjeje, urdhri apo hetimi në proces apo të mundshëm kundër Agjencisë së Zbatimit të Programit, statusin e Autorizimeve të nevojshme për Projektin, rezultatet e ndonjë inspektimi të mundshëm të kryer nga autoritetet rregullatore, ndonjë shkelje të legjislacionit, rregulloreve apo standardeve të zbatueshme dhe veprimeve korrigjuese apo gjobat, si pasojë e kësaj shkeljeje, një përmbledhje të ndonjë njoftimi, raporti apo komunikimi tjetër material të dorëzuar nga Huamarrësi drejtpërdrejt, nëpërmjet Agjencisë së Zbatimit të Programit ose në të kundërt (kur është e përshtatshme), të një autoritet rregullator mbi Çështjet Mjedisore dhe Sociale, që lidhen me Projektin, dhe informacion mbi ndonjë rrethanë tjetër që rezulton në përgjegjësi të Huamarrësit për ndonjë Çështje Mjedisore ose Sociale;

5. Informacion mbi menaxhimin e shëndetit dhe sigurisë në punë dhe një regjistër mbi shëndetin dhe sigurinë në punë të Projektit, duke përfshirë dhe statistikat mbi aksidentet, incidentet që kanë shkaktuar mungesë në punë dhe incidentet e shmangura, informacion mbi masat parandaluese ose zbutëse të marra ose të planifikuara nga Agjencia e Zbatimit të Programit, trajnimet e stafit mbi shëndetin dhe sigurinë në punë dhe nisma të tjera lidhur me menaxhimin e shëndetit dhe sigurisë në punë që ka zbatuar ose planifikuar;

6. Një përmbledhje të ndonjë ndryshimi në Ligjet Mjedisore dhe Sociale që mund të rezultojnë në ndikim material të Projektit; dhe

7. Kopje periodike të informacioneve mbi Çështjet Mjedisore dhe Sociale që Huamarrësi u ka dorëzuar aksionarëve të vet ose publikut të përgjithshëm.

b) Duke filluar nga Data e Hyrjes në Fuqi, Huamarrësi siguron që Agjencia e Zbatimit të Programit dorëzon raportet periodike mbi Projektin të përcaktuara në seksionin 4.04(a)(v) të Termave dhe Kushteve Standardë çdo tremujor, brenda 30 ditëve pas përfundimit të periudhës përkatëse të raportimit, deri në realizimin e plotë të Projektit, në formë dhe përmbajtje të pranueshme për BERZH-in. Këto raporte përfshijnë seksionit specifike të mëposhtme:

1. Informacionin e përgjithshëm si më poshtë:

A. Informacion të detajuar lidhur me konsulentët, kontraktuesit, Tërheqjet dhe Nënprojektet që janë financuar nga Huaja;

B. Informacionin e përcaktuar në formularin e përfshirë në aneksin 2 bashkëlidhur (formulari mund të ndryshohet, sipas rastit, me pëlqimin paraprak të BERZH-it), duke përfshirë burimet përkatëse të të dhënave;

C. Progresin fizik të realizuar gjatë zbatimit të Projektit deri në datën e raportimit dhe gjatë periudhës së raportimit;

D. Vështirësitë ose vonesat konkrete ose të pritshme lidhur me zbatimin e Projektit dhe ndikimin e tyre në planin e zbatimit, hapat konkretë të ndërmarrë ose të planifikuar për të tejkaluar këto vështirësi dhe për të shmangur vonesat, si dhe ndryshimet eventuale të miratuara;

E. Një parashikim të Tërheqjeve të pritshme nga Huaja që do të kryhen gjatë tremujorit të ardhshëm të raportimit, duke përfshirë një përshkrim për secilin Nënprojekt;

F. Ndryshimet e pritshme lidhur me datën e përfundimit të Projektit;

G. Ndryshimet kyçe në stafin e NJZP-së, konsulentët ose kontraktuesit;

H. Çështjet që mund të ndikojnë në koston e Projektit;

I. Ndonjë ngjarje/rast ose veprimtari që mund të ndikojë në realizueshmërinë e ndonjë Pjese të Projektit; dhe

J. Informacione të tjera që lidhen, ndër të tjera, me Huamarrësin, Agjencinë e Zbatimit të Programit, Projektin dhe transaksionet e përfshira në këtë Marrëveshje, të cilat mund të kërkojnë në mënyrë të arsyeshme nga BERZH-i, sipas rastit.

2. Një grafik me shtylla/komponentë mbi progresin e secilit Nënprojekt, duke përfshirë edhe një grafik të shpenzimeve të planifikuara dhe atyre konkrete.

3. Pasqyrat financiare ku paraqiten detaje mbi shpenzimet e kryera për secilin Nënprojekt dhe Tërheqjet, bashkërisht me një deklaratë ku përfshihen:

A. Parashikimet fillestare të kostove;

B. Parashikimet e rishikuara të kostove, nëse ka, të shoqëruara me arsyet për ndryshimet e bëra;

C. Shpenzimet fillestare të parashikuara dhe shpenzimet konkrete deri në datën e raportimit;

D. Arsyet e ndryshimeve ndërmjet shpenzimeve konkrete deri në datën e raportimit dhe shpenzimeve fillestare të parashikuara;

E. Shpenzimet e parashikuara për tremujorët e mbetur të vitit.

4. Një deklaratë të shkurtër mbi gjendjen e pajtueshmërisë me secilin nga angazhimet e përfshira në këtë Marrëveshje.

c) Sa më parë të jetë e mundur, por megjithatë brenda 30 ditëve pas përfundimit të Projektit, Huamarrësi i dorëzon siguron që Agjencia e Zbatimit të Programit i dorëzon BERZH-it (nëse kërkohet nga BERZH-i, të vërtetuar nga Përfaqësuesi i Autorizuar i Huamarrësit ose Agjencisë së Zbatimit të Programit) një raport përfundimtar lidhur me Projektin, ku përcaktohet mënyra e përdorimit të të ardhurave nga Huaja.

d) Huamarrësi mundëson siguron që Agjencia e Zbatimit të Programit mundëson për BERZH-in dhe përfaqësuesit e saj, me kërkesë të BERZH-it:

1. Të vizitojnë objektet dhe kantieret e ndërtimit që lidhen me Projektin;

2. Të shqyrtojnë të gjitha mallrat, punimet dhe shërbimet që janë financuar nga të ardhurat nga Huaja dhe të gjitha impiantet, instalimet, kantieret, punimet, ndërtesat, pronat, pajisjet, regjistrat dhe dokumentet që lidhen me përmbushjen e detyrimeve të Huamarrësit dhe të Agjencisë së Zbatimit të Programit, sipas kësaj Marrëveshjeje; dhe

3. Për këto qëllime, të zhvillojnë takime dhe diskutime me përfaqësuesit dhe punonjësit e Agjencisë së Zbatimit të Programit, siç e gjykon Banka të nevojshme dhe të përshtatshme.

e) Menjëherë pas ngjarjes së ndonjë incidenti ose aksidenti që lidhet me Agjencinë e Zbatimit të Programit ose Projektin, që ka ose mund të ketë efekte serioze të padëshirueshme në mjedis apo në shëndetin ose sigurinë në punë, Huamarrësi siguron se Agjencia e Zbatimit të Programit njofton Bankën dhe menjëherë i dërgon Bankës njoftim kur përcaktohet natyra e incidentit apo e aksidentit në fjalë, si dhe hapat që mund të ndërmarrë Huamarrësi drejtpërdrejt, nëpërmjet Agjencisë së Zbatimit të Programit ose në të kundërt (kur është e përshtatshme) për ta korrigjuar atë. Pa cenuar tërësinë e sa më sipër:

1. Një incident ose aksident cenon Projektin nëse ndodh në ndonjë nga vendet e përdorura për Projektin ose nëse shkaktohet nga objektet, pajisjet, automjetet ndaj ose lidhur me Projektin (pavarësisht nëse përdoren ose jo në ndonjë nga vendet e Projektit dhe pavarësisht nëse përdoren ose jo nga persona të autorizuar apo të paautorizuar);

2. Një incident ose aksident konsiderohet se ka efekte serioze të padëshirueshme në mjedis ose në shëndetin apo sigurinë publike ose në punë, nëse:

A. Ligjet e zbatueshme kërkojnë që incidenti ose aksidenti të njoftohet tek autoritetet qeveritare;

B. Këto incidente ose aksidente përfshijnë humbjen e jetës së një personi (pavarësisht nëse personi është ose jo i punësuar nga Agjencia e Zbatimit të Programit);

C. Më shumë se një person (pavarësisht nëse këta persona janë ose jo të punësuar nga Agjencia e Zbatimit të Programit) ka pësuar lëndime serioze për të cilat është shtruar në spital; ose

D. Incidenti ose aksidenti është ose mund të bëhet publik qoftë nëpërmjet mbulimit mediatic apo ndryshe.

f) Huamarrësi siguron se Agjencia e Zbatimit të Programit njofton menjëherë Bankën lidhur me ndonjë protestë ose petition serioz nga ana e punonjësve ose pjesëtarëve të publikut, që i drejtohet apo lidhet me Agjencinë e Zbatimit të Programit ose Projektin dhe që mund të ketë efekt material të padëshirueshëm për Huamarrësin ose Projektin, apo që është ose mund të bëhet, publik nëpërmjet mbulimit mediatik apo ndryshe. Brenda dhjetë ditëve pas marrjes së njoftimit në fjalë, Huamarrësi siguron se Agjencia e Zbatimit të Programit i dorëzon Bankës një raport të pranueshëm ku përcaktohet rezultati i hetimit të kryer nga Huamarrësi lidhur me këtë protestë, si dhe çdo hap i ndërmarrë ose i propozuar për t'u ndërmarrë nga Huamarrësi drejtpërdrejt ose nëpërmjet Agjencisë së Zbatimit të Programit (kur është e përshtatshme), me qëllim zgjidhjen e problematikave të ngritura në protestën ose petitionin në fjalë.

Neni IV **Angazhime financiare**

Seksioni 4.01 Regjistrat dhe Raportet Financiare

a) Huamarrësi mban (dhe, sipas rastit, siguron që Agjencia e Zbatimit të Programit mban), lidhur me departamentet ose agjencitë e Huamarrësit dhe/ose Agjencisë së Zbatimit të Programit përgjegjëse për kryerjen e Projektit ose ndonjë pjese të tij, procedura, regjistra dhe llogari të përshtatshme që paraqesin, në përputhje me SNRF-në të zbatuar rregullisht, funksionet, burimet dhe shpenzimet lidhur me Projektin dhe për monitorimin dhe dokumentimin e progresit të Projektit (duke përfshirë kostot dhe përfitimet që rrjedhin prej tij).

b) Huamarrësi siguron që Agjencia e Zbatimit të Programit:

1. Mban regjistrat dhe llogaritë e përcaktuara në seksionin 4.01(a), duke përfshirë ato që lidhen me Llogarinë e Veçantë, për çdo Vit Fiskal të audituar nga auditues të pavarur të njohur nga ligji dhe të pranueshëm për Bankën në përputhje me SNRF-në;

2. I dorëzon Bankës sa më parë të jetë e mundur, por megjithatë jo më vonë se gjashtë muaj pas përfundimit të secilit Vit Fiskal, raportet e këtyre auditimeve nga audituesit në fjalë me përmbajtjen dhe detajet që mund të kërkojnë në mënyrë të arsyeshme nga Banka; dhe

3. I dorëzon Bankës informacione të tjera lidhur me regjistrat dhe llogaritë në fjalë, dhe auditimet e tyre përkatëse që mund të kërkojnë nga Banka, sipas rastit, në mënyrë të arsyeshme.

Neni V **Pezullimi; përshpejtimi; anulimi**

Seksioni 5.01 Pezullimi

Seksionit e mëposhtme janë specifikuar për qëllime të seksionit 7.01(a)(xvii) të Termave dhe Kushteve Standardë:

a) kuadri legjislativ dhe rregullator i zbatueshëm për sektorin e turizmit në territorin e Huamarrësit është ndryshuar, pezulluar, shfuqizuar, rrëzuar ose tërhequr në një mënyrë të ndryshme nga ajo e miratuar me shkrim nga Banka.

Seksioni 5.02 Anulimi

a) Nëse, në çfarëdo kohe, Banka vendos se një pagesë nga, ose përdorim i Llogarisë së Veçantë është kryer në mënyrë të ndryshme nga ajo e kërkuar në shtojcën 4 dhe përcakton shumën e Huas ndaj së cilës ka ndodhur ky keqpërdorim, Banka, duke njoftuar Huamarrësin, mund të shuajë të drejtën e Huamarrësit për të kryer Tërheqje të kësaj shume. Me marrjen e njoftimit, shuma në fjalë e Huas anulohet.

b) Banka, duke njoftuar Huamarrësin, mund të anulojë Transhin B në çdo kohë, përpara njoftimit të bërë ndaj Huamarrësit lidhur me disponueshmërinë e Transhit B për disbursim në përputhje me seksionin 2.01(b).

Neni VI Efektiviteti

Seksioni 6.01 Kushtet Paraprake të Efektivitetit

Seksionet e mëposhtme janë specifikuar për qëllime të seksionit 9.02(c) të Termave dhe Kushteve Standardë, si kushte shtesë të efektivitetit të kësaj Marrëveshjeje:

a) Banka ka marrë një njoftim me shkrim nga Huamarrësi, në të cilin konfirmohet se kjo Marrëveshje ka hyrë në fuqi pas ratifikimit nga Parlamenti i Republikës së Shqipërisë dhe botimit të këtij ratifikimi në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë;

b) Marrëveshja e Grantit është ekzekutuar dhe realizuar dhe të gjitha kushtet paraprake lidhur me efektivitetin e saj ose të drejtën e Huamarrësit për të kryer tërheqje lidhur me të, duke përfshirë efektivitetin e kësaj Marrëveshjeje, janë përmbushur;

c) Lista e Nënprojekteve sipas Komponentit A dhe Komponentit B që do të financohen gjatë vitit të parë të Programit, i është dorëzuar Bankës, në formë dhe përmbajtje të pranueshme për këtë të fundit;

d) Agjencia e Zbatimit të Programit ka krijuar NJZP-në me burime të përshtatshme dhe staf të kualifikuar në mënyrën e duhur, në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Bankën dhe që do të jetë funksional gjatë zbatimit të Programit.

Seksioni 6.02 Kushtet Paraprake të Tërheqjes së Parë

Të mëposhtmet specifikohen si kushte shtesë për Tërheqjen e parë sipas kësaj Marrëveshjeje:

a) Agjencia e Zbatimit të Programit ka emëruar konsulentë të kualifikuar të pranueshëm nga Banka për t'i ndihmuar ata në zbatimin dhe mbikëqyrjen e Projektit.

Seksioni 6.03 Opinioni Ligjor

Për qëllime të seksionit 9.03(a) të Termave dhe Kushteve Standardë, opinioni ose opinionet këshilluese jepen nga Ministri i Drejtësisë në emër të Huamarrësit.

Seksioni 6.04 Kushtet Paraprake të Angazhimit të Transhit B

a) Banka, në diskrecionin e saj të vetëm dhe absolut, vendos nëse do ta bëjë Transhit B të disponueshëm për Huamarrësin. Në çdo rast, për sa kohë që Banka nuk bie dakord ndryshe, Banka nuk e bën Transhin B të disponueshëm për Huamarrësin, përveç kur kushtet e mëposhtme paraprake janë përmbushur në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Bankën:

1. Banka ka marrë listën e Nënprojekteve që plotësojnë Kriteret e Pranimi, sipas Komponentit A dhe Komponentit B që do të financohen nga shuma e tërheqjes së parë prej Transhit B;

2. Konsulenti për konsulencën teknike të mbështetur në turizëm është angazhuar dhe raporti konceptual është përfunduar; dhe

3. Konsulenti për konsulencën teknike për Gjininë dhe Përfshirjen është në detyrë dhe raporti konceptual është përfunduar.

b) Pasi Banka të ketë marrë prova të pranueshme siç përcaktohen në seksionin 6.03(a) më sipër dhe të ketë vendosur, në diskrecionin e saj të plotë dhe absolut, që ta bëjë Transhin B të disponueshëm për Huamarrësin, Banka i dërgon njoftim me shkrim Huamarrësit ku konfirmon disponueshmërinë e Transhit B.

Seksioni 6.05 Kushtet Paraprake për të Gjitha Tërheqjet

Seksionet e mëposhtme janë përcaktuar si kushte shtesë ndaj të gjitha Tërheqjeve në këtë Marrëveshje:

a) Banka ka marra prova të pranueshme dhe konfirmim nga Agjencia e Zbatimit të Programit se çdo Nënprojekt që do të financohet nga Tërheqja përkatëse përmbush Kriteret e Pranimit;

b) Projektimet e detajuara për secilin nga Nënprojektet që do të financohet nga Tërheqja përkatëse janë përgatitur nga Agjencia e Zbatimit të Programit; dhe

c) Banka ka konfirmuar se asnjë nga Nënprojektet që do të financohet nga Tërheqja përkatëse nuk është klasifikuar si Nënprojekt i Kategorisë A, sipas Politikës Mjedisore dhe Sociale.

Seksioni 6.06 Zgjidhja për shkak të Mosbërjes efektive

Data 180 ditë pas datës së kësaj Marrëveshjeje është caktuar për qëllime të seksionit 9.04 të Termave dhe Kushteve Standardë.

Neni VII Të ndryshme

Seksioni 7.01 Njoftimet

Adresat e mëposhtme janë specifikuar për qëllime të seksionit 10.01 të Termave dhe Kushteve Standardë:

Për Huamarrësin:

Ministria e Financave e Republikës së Shqipërisë
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 3
Tiranë
Shqipëri

Për dijeni të: Ministrit të Financave dhe Ekonomisë
Email: sekretariamin@financa.gov.al

Për Bankën:
Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
One Exchange Square
Londër EC2A 2JN
United Kingdom (Mbretëria e Bashkuar)

Për dijeni të: Departamentit të Administrimit të Operimit
Email: oad@ebrd.com

Në dëshmi sa më sipër, palët e kësaj Marrëveshjeje, nëpërmjet përfaqësuesve të tyre të autorizuar, kanë nënshkruar këtë Marrëveshje në tri kopje dhe e kanë dorëzuar një kopje në datën dhe vitin e shënuar më sipër.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Nga: _____ nënshkrimi _____

Emri: Anila Denaj

Titulli: Ministër i Financave dhe Ekonomisë

BANKA EVROPIANE

PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM

Nga: _____ nënshkrimi _____

Emri: Jurgen Rigtterink

Titulli: Në cilësinë e Presidentit

SKEDULI 1 PËRSHKRIMI I PROJEKTTIT

1. Qëllimi i Projektit është të krijojë një program investimi për të përmirësuar konkurrueshmërinë e Shqipërisë, duke financuar:

- Infrastruktura për zhvillimin e turizmit në bashkinë e Beratit, Korçës, Fierit dhe Shkodrës (krahës restaurimit, përmirësimit dhe/ose zhvillimit të *site*-ve të trashëgimisë kulturore dhe natyrore që do të financohen vetëm nëpërmjet Financimit nga Granti) (Komponenti A); dhe

- Investimet e përgjithshme në Infrastruktura e bashkisë dhe transportit (Komponenti B) në të gjithë territorin e Huamarrësit.

2. Projekti përbëhet nga pjesët e mëposhtme, të cilat u nënshtrohen ndryshimeve që mund të dakordësohen ndërmjet Bankës dhe Huamarrësit, sipas rastit:

Pjesa 1 – Asistenca teknike për turizmin (për t'u financuar nëpërmjet Financimit nga Granti):

- Paketa turistike;
- Këshilla për biznesin e vogël;
- Trajnime për përfshirjen gjinore dhe ekonomike.

Pjesa 2 – Rehabilitimi përbëhet nga:

Site-t e trashëgimisë kulturore dhe natyrore (për t'u financuar nëpërmjet Financimit nga Granti):

- Asistencë teknike (përgatitja, zbatimi dhe mbikëqyrja e projektit);
- Grante investimi (Nënprojekte për *site*-t e trashëgimisë kulturore dhe natyrore, që përmbushin Kriteret e Pranueshmërisë sipas Komponentit A).

Pjesa 3 – Ndërtimi i infrastrukturës bashkiake dhe të transportit (për t'u financuar nëpërmjet Financimit nga Granti dhe shumës së Huas):

- Asistencë teknike (përgatitja, zbatimi dhe mbikëqyrja e projektit);
- Grante investimi (Nënprojekte infrastrukturore që përmbushin Kriteret e Pranueshmërisë sipas Komponentit dhe A dhe Komponentit B);
- Huaja e BERZH-it (Nënprojekte infrastrukturore që përmbushin Kriteret e Pranueshmërisë sipas Komponentit dhe A dhe Komponentit B).

Pjesa 4 – Instrumenti i ndarjes së riskut – Institucione Financiare (për t'u financuar nëpërmjet Financimit nga Granti):

- Incentiva investimi për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme;
- Asistencë teknike.

3. Nënprojekte për t'u financuar sipas pjesëve 2 dhe 3 më sipër (përdorimi i shumës së Huas dhe/ose Financimit nga Granti) zbatohet për Komponentin A dhe Komponentin B të Projektit si më poshtë:

Komponenti A përfshin:

i. *Site* të trashëgimisë kulturore që do të financohen vetëm nëpërmjet Financimit nga Granti; dhe

ii. Nënprojekte për Infrastruktura për t'u financuar nga shuma e Huas dhe/ose Financimit nga Granti.

Komponenti B përbëhet nga:

i. Nënprojekte për Infrastruktura për t'u financuar nga shuma e Huas dhe/ose Financimit nga Granti.

Secili Nënprojekt duhet të përmbushë Kriteret e Pranueshmërisë të përcaktuara në skedulin 2 të Marrëveshjes së Huas. Secili Nënprojekt që do të financohet plotësisht ose pjesërisht nga të ardhurat nga Huaja, duhet që fillimisht të konsiderohet si pjesë e përkufizimit të Infrastrukturës, siç përcaktohet në Marrëveshjen e Huas.

Nënprojektet e përcaktuara treguese do të zbatohen në përputhje me Planin e Prokurimit.

3. Projekti pritet të përfundojë më 31 dhjetor 2025.

SKEDULI 2

KRITERET E PRANIMIT PËR NËNPROJEKTET

Komponenti A

Për Nënprojektet që lidhen me zhvillimin e Infrastrukturës së turizmit, transportit dhe atë të bashkisë sipas Komponentit A - kriteret e pranimit bazohen në tri elemente: i. analiza shumëkriterëshe e vendimit; ii. analiza sfidë-zgjidhje; dhe iii. Norma Ekonomike e Brendshme e Kthimit (EIRR) mbi 5 për qind.

Për *site*-t e trashëgimisë kulturore që do të financohen plotësisht nga Financimi nga Granti, sipas Komponentit A - kriteret e pranimit bazohen në dy elemente: i. analiza shumëkriterëshe e vendimit; dhe ii. analiza sfidë-zgjidhje. *Site*-t e trashëgimisë kulturore nuk u nënshtrohen kriterëve të EIRR-së.

Rezultati i përgjithshëm i ponderuar bazohet në dy rezultatet për analizat me ponderimin e mëposhtëm: 70 për qind për analizën shumëkriterëshe dhe 30 për qind për analizën sfidë-zgjidhje. Në mënyrë që një Nënprojekt të financohet, ai duhet të ketë një rezultat mesatar të ponderuar prej 2.50 dhe një EIRR të pranueshëm (mbi 5 për qind).

i. Analiza shumëkriterëshe

Analiza shumëkriterëshe përbëhet nga tri nivele kriteresh me rëndësi të ndryshme të ndikimit të tyre në rezultatin përfundimtar të projektit.

Faktorët/rezultatet e vendimmarrjes		1 (i ulët)	3 (mesatar)	5 (i lartë)
Ndikimi i Turizmit (75 për qind në ndikim)	Ndikimi i rritjes së numrit të vizitorëve (çdo ditë dhe brenda natës)	Deri në rritje 5%	5% deri në 10%	mbi 10%
	Koha e qëndrimit	0.0 - 0.1	0.1 - 0.2	mbi 0.2
	Raporti P/K i të ardhurave nga turizmi	Me pak se 1	1 deri në 2	mbi 2
	Gjenerimi i punësimit direkt/indirekt	Deri në 10	10 deri në 30	mbi 30
	Ndikimi në portofolin e produktit të turizmit dhe përvojën e vizitorëve	s'ka/ndikim i ulët në zhvillimin e produktit	Përmirësimi i produktit ekzistues	Produkt i ri
	Ndikimi në njohjen e turizmit dhe krijimit të imazhit	s'ka/ndikim i ulët i brendshëm	Ndikimi i brendshëm	Ndikimi i brendshëm dhe ndërkombëtar
Maturimi i projektit (15 për qind në ndikim)				
Faza e maturimit të projektit		Idetja/vizioni i projektit	Parafizibiliteti dhe projektimi paraprak	Studim fizibiliteti me përgatitje të lartë dhe/ose projektim të detajuar
Mbështetja e projektit (10 për qind në ndikim)	Sinergia me projektin e donatorit/bashkisë që lidhet me zhvillimin	Nuk ka lidhje	Ka lidhje në nivelin e bashkisë	Ka lidhje
	Vullneti/gatishmëria e bashkisë për të mbështetur nismën	Nuk ka mbështetje të konsiderueshme nga bashkia - Nuk ka mbështetje	Ka mbështetje në përgatitjen e projektit	Aftësia/gatishmëria për Menaxhimin e projektit
	Vullneti/gatishmëria kombëtare për të mbështetur nismën	(e konfirmuar) për ID e projektit në nivel kombëtar	Nuk ka	ID e projektit (e konfirmuar) në nivel kombëtar

ii. Analiza sfidë-zgjidhje

Duke u bazuar në sfidat e identifikuar për secilin nga Rajonet e Përcaktuara, studimi shqyrtues për zhvillimin e turizmit në Shqipëri, i datës 14 qershor 2018, i përgatitur nga Horwath HTL (Studimi Shqyrtues) ka vlerësuar secilën nga sfidat që cenojnë zhvillimin e turizmit me vlerat: 1 (e ulët), 3 (mesatare) dhe 5 (e konsiderueshme). Rezultati i kësaj qasjeje është një përmbledhje e sfidave të identifikuar për secilën bashki, sipas nivelit të cenimit të zhvillimit të turizmit nga sfida.

Më pas, secila nga sfidat u ballafaqua me sfidën e identifikuar në secilin nga Rajonet e Përcaktuara nga perspektiva se deri në cilën masë arrin projekti i propozuar që të trajtojë sfidën e identifikuar në mënyrën e mëposhtme: Ndikimi i trajtimit të sfidës 1 (i ulët), 3 (mesatar) dhe 5 (i konsiderueshëm).

Komponenti B

Nënprojektet e Infrastrukturës në mbarë territorin e Huamarrësit - Kriteret e pranimi për të identifikuar Nënprojektet varen nga fakti nëse nënprojekti i përket sektorit të transportit (rrugë) apo nëse nënprojekti lidhet me infrastrukturën e bashkisë (furnizimi me ujë, ujërat e ndotura, ndriçimi i rrugëve, mbetjet e ngurta etj.):

i. Kriteret e pranimi për Nënprojektet e Infrastrukturës së bashkisë

Investimet për Infrastrukturën e bashkisë do të përcaktohen duke u bazuar në një vlerë të EIRR-së mbi 5 për qind.

ii. Kriteret e pranimi për Nënprojektet e Infrastrukturës së transportit

Investimet për Infrastrukturën e transportit do të përcaktohen duke u bazuar në:

A. Një vlerë të EIRR-së mbi 5 për qind; dhe

B. Në rastin e rrugëve, nëse rruga lehtëson lidhjen dhe aksesueshmërinë në Parqet Kombëtare të Shqipërisë dhe/ose seksioneve të tjera me interes turistik (Po/Jo)

Të përgjithshme

Agjencia e Zbatimit të Programit mund t'u referohet gjetjeve të Studimit Shqyrtues për qëllime të vlerësimit të nënprojekteve të mundshme të identifikuara në atë dokument, në përputhje me kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara më sipër.

SKEDULI 3 KATEGORITË DHE TËRHEQJET

1. Tabela bashkëlidhur kësaj shtojce përcakton Kategoritë, shumën e Huas që i është caktuar secilës Kategori dhe përqindjen e shpenzimeve që do të financohen për secilën Kategori.

2. Pavarësisht dispozitave të paragrafit 1 më sipër, nuk do të kryhet asnjë Tërheqje për të mbuluar shpenzimet e kryera a para datës së Marrëveshjes së Huas.

3. Banka ka të drejtën të kryejë tërheqje në emër të Huamarrësit për t'i shlyer vetes Komisionin Paraprak, në masën dhe kur të bëhet i pagueshëm.

Dokument bashkëlidhur skedulit 3

Kategoria	Shuma e Përcaktuar e Huas në Valutën e Huas (euro)	Përqindja e Parashikuar e Shpenzimeve që do të Financohen
1. Nënprojektet që përmbushin Kriteret e Pranimi dhe që konsiderohen si Infrastrukturë sipas përcaktimit në Marrëveshjen e Huas	59,400,000	Deri në 100% të vlerës së kontratës (duke përjashtuar taksat) për çdo Nënprojekt, pa tejkaluar 80% të shpenzimeve totale të përgjithshme për të gjitha Nënprojektet në përputhje me Planin e Prokurimit, pa përfshirë Taksat)
2. Komisioni Paraprak	600,000	100%
TOTALI	60,000,000	

SKEDULI 4 LLOGARIA E VEÇANTË E PËRCAKTUAR

1. Për qëllime të kësaj shtojce, termat e mëposhtëm nënkuptojnë:

“Shpenzime të Pranueshme” nënkupton shpenzimet që lidhen me kostot e arsyeshme të mallrave, punimeve dhe shërbimeve të nevojshme për Projektin dhe që do të financohen nga të ardhurat nga Huaja dhe që janë caktuar, sipas rastit, te një Nënprojekt i vlefshëm që përmbush

Kriteret e Pranimit dhe që konsiderohet i lidhur me Infrastrukturën, bazuar në përcaktimin e bërë në Marrëveshjen e Huas.

“Bilanci Maksimal i Llogarisë së Veçantë të Përcaktuar” nënkupton një shumë në vlerën: i. deri në, por pa përfshirë Datën e Disponueshmërisë së Transhit B, 3,000,000 euro; dhe ii. nga dhe pa përfshirë Datën e Disponueshmërisë së Transhit B, 6,000,000 euro.

“Shuma Minimale e Tërheqjes nga Llogaria e Veçantë e Përcaktuar” nënkupton një shumë në vlerën 250,000 euro.

2. Pagesat e kryera nga Llogaria e Veçantë e Përcaktuar do të shkojnë vetëm për Shpenzimet e Pranueshme në përputhje me dispozitat e kësaj shtojce.

3. Pasi Banka të ketë marrë prova të pranueshme që Llogaria e Veçantë e Përcaktuar është krijuar në përputhje me termat dhe kushtet e pranueshëm për Bankën, Huamarrësi, mund të tërheqë nga Shuma e Disponueshme një vlerë që nuk tejkalon Bilancin Maksimal të Llogarisë së Veçantë të Përcaktuar dhe që është më e madhe sesa Shuma Minimale e Tërheqjes së Llogarisë së Veçantë dhe ta depozitojë atë në Llogarinë e Veçantë të Përcaktuar

4. Më pas, Huamarrësi, mund të tërheqë shuma të tjera shtesë nga Shuma e Disponueshme dhe t'i depozitojë në Llogarinë e Veçantë të Përcaktuar, shuma që u nënshtrohen kufizimeve të përcaktuara në paragrafin 6 më poshtë dhe përmbushjes së kushteve të mëposhtme për secilën Tërheqje të kërkuar:

a) Huamarrësi t'i ketë dorëzuar Bankës pasqyrat e llogarive dhe dokumentet përkatëse dhe çdo provë tjetër të kërkuar nga Banka, për të provuar se shumat e disbursuara nga Llogaria e Veçantë e Përcaktuar janë shfrytëzuar siç duhet.

b) Pasi të jetë kryer Tërheqja e kërkuar dhe të jetë depozituar në Llogarinë e Veçantë të Përcaktuar shuma nga kjo Tërheqje, bilanci i Llogarisë së Veçantë të Përcaktuar të mos tejkalojë Bilancin Maksimal të Llogarisë së Veçantë të Përcaktuar.

c) Përveçse siç do të bjerë dakord Banka, sipas rastit, shuma e kërkuar e Tërheqjes që do të depozitohet në Llogarinë e Veçantë të Përcaktuar nuk duhet të jetë më e vogël se sa Shuma Minimale e Tërheqjes e Llogarisë së Veçantë të Përcaktuar.

5. Pa cenuar kërkesat e paragrafit 4(a) më sipër, Huamarrësi, paraqet, kurdo që mund të kërkohet, në mënyrë të arsyeshme nga Banka, një raport të bilancit dhe detajeve të tjera të Llogarisë së Veçantë të Përcaktuar, duke përfshirë deklaratat e llogarisë dhe dokumente e prova të tjera që mund të kërkojnë nga Banka për të vërtetuar se pagesat e kryera nga Llogaria e Veçantë e Përcaktuar janë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këtë skedul.

6. Pavarësisht dispozitave të paragrafit 4 të këtij skeduli, Huamarrësi, nëse Banka nuk bie dakord ndryshe, nuk tërheq fonde nga Shuma e Disponueshme për t'i depozituar në Llogarinë e Veçantë të Përcaktuar:

a) nëse, në ndonjë moment, Banka ka vendosur se të gjitha Tërheqjet e mëtejshme duhet të kryhen në përputhje me dispozitat e seksionit 2.03(a); ose

b) kur Shuma e Disponueshme të jetë në vlerën e dyfishit të shumës së Bilancit Maksimal të Llogarisë së Veçantë të Përcaktuar.

Më pas, Tërheqjet ndjekin procedurat që përcakton Banka nëpërmjet njoftimit të Huamarrësit. Tërheqjet e mëtejshme kryhen vetëm pasi dhe në masën që Banka është bindur se shumat e mbetura të depozituara në Llogarinë e Veçantë të Përcaktuar deri në datën e këtij njoftimi do të përdoren për të shlyer Shpenzimet e Pranueshme.

7. Nëse Banka, në çfarëdo kohe, vendos se ndonjë pagesë apo përdorim i Llogarisë së Veçantë të Përcaktuar:

a) është kryer për të shlyer një shpenzim ose ka qenë në një shumë të papranueshme, sipas paragrafit 2 të këtij skeduli; ose

b) nuk justifikohet me provat që i janë paraqitur Bankës, atëherë Banka mund t'i kërkojë Huamarrësit:

1. Të paraqesë provat shtesë që mund të kërkojë Banka; dhe/ose

2. Të depozitohet në Llogarinë e Veçantë të Përcaktuar (ose, nëse kërkohet nga Banka, të shlyejë këtë të fundit) një shumë në vlerën e pagesave në fjalë ose në vlerën e pjesës së papranueshme apo të pajustificueshme.

Në rast se Banka merr këtë vendim sipas nënparagrafëve (a) ose (b) më sipër, përveç kur Banka bie dakord ndryshe, nuk do të kryhet asnjë Tërheqje për t'u depozituar në Llogarinë e Veçantë të Përcaktuar, deri kur Huamarrësi: A. të ketë depozituar në Llogarinë e Veçantë të Përcaktuar apo t'i ketë shlyer Bankës një shumë në vlerën e pagesës në fjalë (ose të pjesës përkatëse), që është përcaktuar si e papranueshme ose e pajustificueshme; ose B. të ketë paraqitur prova shtesë të kënaqshme për Bankën që provojnë se shumtat e disbursuara më parë nga Llogaria e Veçantë e Përcaktuar janë shfrytëzuar në mënyrën e duhur.

8. Nëse:

a) Banka, sipas rastit, vendos se ndonjë nga shumtat e papaguara në Llogarinë e Veçantë të Përcaktuar nuk do të nevojitet për të mbuluar pagesat e mëtejshme të Shpenzimeve të Pranueshme; ose

b) Banka udhëzon Huamarrësin që t'i shlyejë Bankës një shumë në vlerën e përcaktuar në paragrafin 7(2),

atëherë Huamarrësi, menjëherë pas njoftimit nga Banka, i shlyen Bankës një pjesë të Huas në vlerën e kësaj shume. Për këtë qëllim, në përputhje me paragrafin 10 më poshtë, kërkesa që parapagimet e Huas duhet të kryhen në Datat e Pagesës së Interesit shuhet.

9. Huamarrësi, duke njoftuar paraprakisht Bankën në përputhje me seksionin 3.07(a) të Termave dhe Kushteve Standardë, parapaguan në cilëndo nga Datat e Pagesës së Interesit të gjithë ose një pjesë të shumës së fondeve të depozituara në Llogarinë e Veçantë të Përcaktuar.

10. Në përputhje me paragrafët 8 ose 9 më sipër, çdo parapagim kryhet sipas seksionit 3.07 të Termave dhe Kushteve Standardë; me kusht që: a) pavarësisht seksionit 3.07(c)(i)(A) të Termave dhe Kushteve Standardë, këto parapagime nuk i nënshtrohen Shumës Minimale të Parapagimit; dhe b) çdo parapagim që kryhet në një datë ndryshe nga Data e Pagesës së Interesit i nënshtrohet pagesës së Kostove të Shlyerjes së Hershme, në përputhje me seksionin 3.10 të Termave dhe Kushteve Standardë. Çdo parapagim në përputhje me paragrafët 8 ose 9 më sipër zbatohet nga Banka sipas seksionit 3.07(c)(ii) të Termave dhe Kushteve Standardë.

ANEKSI 1
PLANI I VEPRIMIT MJEDISOR DHE SOCIAL

Nr.	Veprimi	Reziqet Mjedisore dhe Sociale (Detyrimet/ Përfitimet)	Kërkesa (Legjislative, KP BERZH, Praktika e Mirë)	Burimet, Nevojat për Investim, Përgjegjësia	Plani kohor	Kriteret e Synuara dhe të Vlerësimit për Zbatimin e Suksesshëm	Statusi
1.1	☐ Të vazhdojë zbatimin e PVMS-së për Projektin për Rugët Rajonale dhe Lokale në Shqipëri dhe të zbatohet për Projektin e Infrastrukturës dhe Zhvillimit të Turizmit në Shqipëri. ☐ Të sigurohet që FSHZH-ja (Njësia e Zbatimit të Projektit/NJZP) të shqyrtojë Nënprojektet e propozuara, në mënyrë që të mos përfshijnë elemente të Kategorisë A, sipas Programit të Infrastrukturës dhe Zhvillimit të Turizmit në Shqipëri. ☐ Të sigurohet që konsulentit i punësuar në Programin e Infrastrukturës dhe Zhvillimit të Turizmit në Shqipëri të trajnojnë FSHZH-në (Njësinë e Zbatimit të Projektit/NJZP) që të jetë e aftë të kategorizojë në mënyrën e duhur nënprojektet dhe të përjashtojë elementet e Kategorisë A nga Programi.	– Optimizimi i menaxhimit mjedisor nëpërmjet një sistemi të formalizuar – Pajtueshmëri me kërkesat e BERZH-it	– KP1 e BERZH-it - Sistemet e Menaxhimit Mjedisor dhe Social – Praktika e mirë	Burimet e brendshme të FSHZH-së Njësia Mjedisore dhe Sociale Hartimi i projektimit i trajtuar në detaje, kur është e përshtatshme	Përpara zbatimit të Projektit	Të zhvillohet dhe të zbatohet projekti i SMMS-së, duke përfshirë formatin e PMMS-së që përdoret për të gjitha projektet Të përcaktohen dhe t'u komunikohen qartë të gjithë punëtorëve rolet dhe përgjegjësitë për zbatimin e Projektit SMMS Rishikim vjetor i projekteve SMMS nga FSHZH-ja Dorëzim i Raportit Vjetor të Monitorimit nga FSHZH-ja pranë BERZH-it	
10.3	Sigurohuni që FSHZH-ja të publikojë një përmbledhje joteknike të secilit nënprojekt të Programit të Infrastrukturës dhe Zhvillimit të Turizmit në Shqipëri. Sigurohuni që FSHZH-ja të dorëzojë përmbledhjen joteknike të secilit nënprojekt të Programit të Infrastrukturës dhe Zhvillimit të Turizmit në Shqipëri pranë BERZH-it, për shqyrtim përpara publikimit të tij (me qëllim që BERZH-i të konfirmojë se nuk i përket Kategorisë A).	Pajtueshmëri me kërkesat e BERZH-it	KP10	Burimet e brendshme	Hartimi dhe zbatimi i projektit	Publikimi i përmbledhjes joteknike të nënprojekteve	

ANEKSI 2
RAPORTIMI TREMUJOR

	Periudhat e raportimit			Totali deri në datën përkatëse
	dd.mm.vvvv– dd.mm.vvvv	dd.mm.vvvv– dd.mm.vvvv	dd.mm.vvvv– dd.mm.vvvv	Deri më dd.mm.vvvv
Numri i Nënprojekteve të përfunduara të Infrastrukturës				
Vlera totale e Nënprojekteve të përfunduara të Infrastrukturës (euro)				
Vlera totale e disbursuar nga Huaja që është përdorur për të financuar Nënprojektet e Infrastrukturës (euro)				
Numri i Nënprojekteve të Infrastrukturës nën kujdes teknik				
Numri i Nënprojekteve të Infrastrukturës me projekte të detajuara të përfunduara, por ende të patenderuara				
Numri i Nënprojekteve të tenderuara të Infrastrukturës				